

VENDIM
Nr. 541, datë 27.7.2016

PËR KALIMIN NË PRONËSI TË BASHKISË VLORË TË PRONËS ME SIPËRFAQE 371 m² TRUALL, PJESE E PRONËS ME NR. 17, ME EMËRTIMIN “REZIDENCA QEVERITARE VLORË”, DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 1058, DATË 16.7.2008, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI KËSHILLIT TË MINISTRAVE, PËR DREJTORINË E SHËRBIMEVE QEVERITARE”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 3, shkronja “F”, 5, 7, 8 e 17, të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001, “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, dhe të neneve 13 e 15, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në pronësi të Bashkisë Vlorë të sipërfaqes 371 (treqind e shtatëdhjetë e një) m² truall, pjesë e pronës me nr. 17, me emërtimin “Rezidenca Qeveritare Vlorë”, sipas planimetrisë bashkëlidhur, me qëllim ndërtimin e rrugës “Dhimitër Konomi”, Vlorë.
2. Në listën e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, që i bashkëlidhet vendimit nr. 1058, datë 16.7.2008, të Këshillit të Ministrave, të hiqet prona e përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi.
3. Bashkisë Vlorë i ndalohet të ndryshojë destinacionin e pronës së përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, ta tjetërsojë ose t’ua japë në përdorim të tretëve.
4. Ngarkohen ministri i Punëve të Brendshme, Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare, Bashkia Vlorë dhe kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

PLAN VENDOSJA E OBJEKTIT.

